

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik		
Titulli i lëndës:	E drejta procedurale civile		
Niveli:	Bachelor (studime themelore)		
Statusi lëndës:	E detyrueshme		
Viti i studimeve:	IV (Semestri VII)		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	7		
Koha / lokacioni:	Prishtinë		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. iur. Iset Morina LL. M. (Würzburg)		
Detajat kontaktuese:	Konsultimet: Fizikisht: Në fund të ligjëratës Virtualisht: Sipas marrëveshjes Adresa elektronike: iset.morina@uni-pr.edu		
	Lënda “E drejta procedurale civile” ka të bëjë kryesisht me të drejtën procedurale kontestimore dhe atë me fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e procedurës kontestimore. Në këtë lëndë do të trajtohen edhe çështjet e procedurës sipas mjeteve të goditjes së vendimeve dhe procedurat e veçanta kontestimore.		
Qëllimet e lëndës:	Me këtë lëndë tentohen të arrihen njohuritë bazë dhe të domosdoshme se si konstatohet një e drejtë subjektive private, kryesisht në rrugë gjyqësore. Derisa në të drejtën materiale trajtohet çështja e ekzistimit të së drejtës, në të drejtën procedurale trajtohet çështja e realizimit të së drejtës subjektive private.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Studenti do të jetë në gjendje që të kuptojë drejtë, se si realizohet një e drejtë subjektive private në rrugën gjyqësore; - Studenti do të kuptojë se si fillon, zhvillohet procedura civile para gjykatës së shkallës së parë; - Studenti do të kuptojë se si mund të zhvillohet procedura civile sipas mjeteve të goditjes së vendimeve; - Studenti do të kuptojë, se si mund të zhvillohen procedurat e posaçme kontestimore; - Studenti do të jetë në gjendje, që të zgjedhë rastet duke u bazuar në ligj. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	1	3
Ushtrime teorike/laboratorike	2	2	2
Punë praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4

Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,seminare	2	/	2
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	/	/	/
Përgaditja përfundimtare për provim	/	/	/
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	/	/	/
Projektet,prezentimet ,etj	/	/	/
Totali			

<p>Metodologjia e mësimdhënies:</p>	<p>Koncepti didaktik</p> <p>Ligjëratat do të ofrohen duke respektuar format e avancuara për mësimdhënie. Do të zbatohet metodologjia interaktive, e cila prezumon aktivitetet si nga ana e mësimdhënësit ashtu edhe të studentëve.</p> <p>Metodologjia e ligjërimit do të orientohet në krijimin e mundësive të studentët për të zotëruar dhe fituar njohuritë për të drejtën e procedurës civile pozitive. Do të pretendohet në shtjellimin e qartë e të saktë teorik të instituteve juridike në të drejtën e procedurës civile. Ofrimi i shembujve nga praktika gjyqësore do të ketë për qëllim arritjen e shkallës së aftësisimit të studentëve për interpretimin e ligjit dhe krijimin e opinionit ligjor. Aspektet komparative nga të drejtat e vendeve të tjera do të ofrohen vetëm në rastet e nevojshme për të plotësuar zbrazëtitë teorike të së drejtës në Kosovë dhe për të avancuar njohuritë juridike.</p> <p>Interpretimi i ligjit nuk paraqet qëllim në vete. Shumë më tepër, përmes interpretimit ligjor pretendohet arritja e një konkluzioni. Deri te arritja e konkluzionit për një problem juridik do të duhej të respektohej skema e caktuar. Në këtë kuptim, studentët do të aftësohen që të jenë në gjendje për të krijuar opinionin juridik lidhur me një çështje dhe për të arritur te një konkluzion, i cili ka bazën ligjore dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi. Theks të veçantë do t'i kushtohet aftësisimit për analizë juridike në bazë të argumenteve.</p>
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Me këtë i referohemi shprehimisht Rregullores së përgjithshme për sistemin e vlerësimit të performancës së studentëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vijimi i rregullt dhe angazhimi në ligjërata dhe ushtrime - Testi provues me qëllim ushtrimi: në fund të muajit nëntor (data e saktë caktohet më vonë) - Testi kryesor: në fund të muajit dhjetor (data e saktë caktohet më vonë); Kusht për pjesëmarrje në testin kryesor është vijueshmëria në ligjërata dhe pjesëmarrja

	<p>në testin provues.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Testi është mundësi dhe e drejtë dhe jo detyrim i kandidatit! <p>Në test dhe provim lejohet konsultimi i ligjit. Ligji nuk guxon të jetë i komentuar me fjalë. Lejohet nënvizimi dhe hijëzimi (p. sh. me ngjyrë) i dispozitave dhe mund të shënohet vetëm numri i dispozitës. Në teste dhe provime gjithmonë do të kontrollohen tekstet ligjore dhe nëse konstatohet ndonjë shkelje e këtyre rregullave (mjafton një fjalë) do të anulohet testi respektivisht provimi.</p> <p>Nota do të ndërtohet në bazë të testit kryesor dhe vijimit të rregullt. Nota e arritur në bazë të testit kryesor do të përshkruhet në afatin e rregullt të provimeve. Kandidati duhet natyrisht të paraqes provimin në një afat të provimeve, por pa pasur nevojë t'i nënshtrohet provimit. Përshkrimi i notës bëhet në orarin e përshkrimit të notave në afatet përkatëse.</p> <p>Për të kaluar provimin nevojiten së paku 55 pikë. 55-64 pikë/nota 6; 65-74 pikë/nota 7; 75-84 pikë/nota 8; 85-94 pikë/nota 9; 95-100/nota 10</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Brestovci, Faik/Morina, Iset/Qehaja, Rustem, E drejta procedurale civile – Procedura kontestimore, Prishtinë 2017 - Morina, Iset, E drejta procedurale civile, në: Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë 2019 <p>Ligjet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji për procedurën kontestimore - Ligji për Gjykata - Ligji për Gjykatën Komerciale- <p>(Secili student duhet të ketë me vete tekstet ligjore në ligjërata dhe ushtrime)</p>
Literatura shtesë dhe e rekomanduar:	<ul style="list-style-type: none"> - Morina, Iset/Nikçi, Selim, Ligji për procedurën kontestimore (LPK-Komentar) Prishtinë 2012 - Morina, Iset/Muharremi, Robert, Arbitrazhi dhe procedura e arbitrazhit, Botimi i dytë, Prishtinë 2024 - Morina, Iset (Editor), Fjalor juridik – E drejta private, publike dhe penale (shqip-serbisht-anglisht-gjermanisht), Prishtinë 2019 - Doracaku i procedurës kontestimore (Manuskript në formën elektronike përgatitur nga USAID; Do të jepet në dispozicion të studentëve)

Planprogrami i ligjëratave:	
Java	Struktura e ligjëratave
Java e parë:	<ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në të drejtën procedurale civile - Burimet juridike të së drejtës procedurale civile - Ndarja e procedurës civile
Java e dytë:	<ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i gjykatave - Metodatat e tjera alternative për zgjidhjen e kontesteve civile - Parimet e procedurës kontestimore
Java e tretë:	<ul style="list-style-type: none"> - Subjektet e procedurës kontestimore - Përbërja e gjykatës - Përfundimi i gjykatës nga procesi konkret
Java e katërt:	<ul style="list-style-type: none"> - Vlera e objektit të kontestit - Kompetenca e gjykatës
Java e pestë:	<ul style="list-style-type: none"> - Palët
Java e gjashtë:	<ul style="list-style-type: none"> - Veprimet procedurale - Parashtrësit - Seanca - Afatet
Java e shtatë:	<ul style="list-style-type: none"> - Kthimi në gjendjen e mëparshme - Prezumi i procedurës
Java e tetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Testi ushtrues
Java e nëntë:	<ul style="list-style-type: none"> - Padia dhe llojet e padive - Kundërpadia - Bashkimi i kërkesëpadive - Bashkëndërgjyqësia dhe ndërhyrja
Java e dhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi “i zakonshëm” i një procesi civil - Seanca përgatitore dhe për seanca për shqyrtimin kryesor
Java e njëmbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Prova dhe administrimi i saj - Ndalja e përkohshme e procedurës
Java e dymbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Përfundimi i procedurës - Përfundimi sipas veprimeve disponibile të palëve - Llojet e aktgjyqimeve
Java e trembëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Kollokviumi (<i>Kusht është pjesëmarrja në testin ushtrues</i>)
Java e katërbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Procedura sipas mjeteve të rregullta të goditjes së vendimeve - Procedura sipas mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve
Java e pesëmbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Procedurat e posaçme kontestimore
	<u>Në sesionin e dytë të secilës ligjëratë do të zgjidhen rastet në mënyrën dhe formën e opinionit ligjor sipas metodës interaktive të didaktikës!</u>